*Notere Silvana MERKO*
*Dhoma e Notereve Tirane*
*Blv " Gjergj Fishta"*
*Nr. 3775 Repertori*
*Nr 717 Koleksioni*

PULLE TAKSE

*Tirane ,me 04/06/2005*

# KONTRATE SHITJE KUOTASH

Ne Tirane , sot me date 04/06/2005 (dymije e pese) para meje noteres Silvana Merko,anetare e dhomes se notereve Tirane me seli ne blv "Gjergj Fishta" m'u paraqiten personalisht palet per lidhjen e kesaj kontrate shitjeje:

**SHITESIT** : ADRIANA GUCI,shtetase shqiptare, e bija e Myslymit, dtl. 1969, lindur ne Tepelene, dhe banuese ne Tepeloene, madhore, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, e njohur prej meje noteres.
ETLEVA DROBONIKU, e bija e Stefanit, dtl. 1974, lindur ne Fier dhe banuese ne Tirane, madhore, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar,e njohur prej meje noteres.

**BLERESI** : ASTRIT BAKA, madhor, lindur ne Tepelene dhe banues ne Tirane, madhor, i njohur prej meje noteres per identitetin e tij.

**OBJEKTI** : Shitblerja e 100 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " A& E " SH.P.K. ne baze te ligjit nr. 7667 date 28.1.1993 dhe ne ligjin nr.7638 date 19.11. 1992.

Shoqeria tregetare me pergjegjesi te kufizuar "A&E " sh.p.k. eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr. 31927 date 13.07.2004 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Me kerkese te dy ortaket e shoqerise kerkojne te bejne shitjen e kuotave.

Ne keto kushte, nisur edhe nga fakti se ne mbledhjen e zakoneshme te shoqerise , eshte vendosur te behet shitja e 100% te kuotave te kapitalit te shoqerise nga dy ortaket tek z. Astrit Baka, ne baze te nenit 47 paragrafi i pare i ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare " ortaket legjitimohen te bejne kete shitje.

M e kete kontrate shitesit Adriana Guci dhe Etleva Droboniku i shesin bleresit Astrit Baka 100 % te kuotave te kapitalit themeltar qe ato zoterojne baraz me 100 ( njeqind ) kuota te shoqerise "A&E "sh.p.k..

Shitesit deklarojne se keto kuota i shesin me vlere te barabarte me vleren e tyre reale ne shumen 100 000 ( njeqind mije ) leke.

Shitesit deklarojne se heqin dore nga cdo e drejte e tyre mbi pjesen e kapitalit qe shesin duke ia kaluar keto te drejta teresisht bleresit .

Palet deklaruan se bleresi ka paguar cmimin e plote te kuotave qe ai blen dhe shitesi e ka marre te plote kete shume.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate shitjeje bleresi Astrit Baka behet ortak i vetem ne shoqerine " A&E " sh.p.k. me 100 % te kuotave te kapitalit te kesaj shoqerie.

Me kryerjen e ketij akti, bleresi behet zoterues i te gjitha disponibiliteteve ligjore dhe fizike te deklaruara me lart , qe ka shoqeria "A&E" per pjesen e vet.

Detyrimet te tjera , te padeklaruara ne kete akt, mbeten ne pergjegjesi te shitesit.

*Kontrata redaktohet ne baze te ligjit . nr.7638 date 19.11. 1992 dispozitat e te cilit u bahen te qarta paleve.*

Palet deklaruan se i pranojne dhe i kuptojne ato.

Perfundimisht ,u muar prej meje noteres ky akt ,u perpilua ne tre kopje me fuqi te njejte ,u gjet konform vullnetit te lire te paleve ,nenshkruhet prej tyre rregullisht dhe ne perfundim prej meje noteres per t'i dhene fuqi ligjore.

| SHITESI | BLERESI | NOTER |
| --- | --- | --- |
| emri & mbimeri | emri & mbiemri | Marko |